




Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 177 /19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërjez.Nuhi Paçarizi– Kryetar, z.Blerim Dina - Referues, z.Goran Milenković– Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “N.T.P YessPharma” Prishtinë, kundër Njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull të prokurimit: “Furnizim me pajisje për QKMF-kontratë dy vjeçare”, me numër të prokurimit: 613-19-1063-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –KK- Lipjan, më datën 29.05.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, sie bazuar ankesa e operatorit ekonomik “N.T.P YessPharma” Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje për QKMF-kontratë dy vjeçare”, me numër të prokurimit: 613-19-1063-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –KK- Lipjan.

II. **OBLIGOHET**, autoriteti kontraktues AK/ Komuna e Lipjanit ti bëjë ndryshimet në dosje të tenderit, dhe të veproj konform nenit 53.7 të LPP-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje për QKMF-kontratë dy vjeçare”, me numër të prokurimit: 613-19-1063-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK- Lipjan.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Meqenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “N.T.P YessPharma” Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:05.04.2019

Afati i fundit për dorëzim të ofertave me dt:25.04.2019

Kërkesa për rishqyrtim me dt:09.04.2019.

Operatori ekonomik ankues “N.T.P YessPharma” Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 19.04.2019 me nr. 177/19, kundër Njoftimit për, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje për QKMF-kontratë dy vjeçare”, me numër të prokurimit: 613-19-1063-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK- Lipjan, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 19.04.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore, Eksperti Shqyrtues në raportin e dt:26.04.2019, konstaton dhe sqaron sinë vijim:

Autoriteti Kontraktues - “Kuvendi Komunal Lipjan”, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, me vlerë të mesme. Më poshtë janë paraqitur pretendimet ankimore si dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik.

OE ankues pretendon se specifikacioni teknik i pajisjes me numër rendor 3-Ultrasound i është përshtatur prodhuesit Samsung Medison dhe si i tillë pamundëson pjesëmarrjen e prodhuesve të tjerë, përfshirë edhe brendin General Electric.

Në lidhje me këtë pretendim ankimor Eksperti teknik ka kërkuar informata shtesë nga OE ankues me datë 17.05.2019 përmes emailit dhe në të njëjtën ditë ka pranuar nga OE sqarimin se pretendimi ka të bëjë specifikisht me elementin ku kërkohet që monitori të jetë brend i njëjte si prodhuesi i ultrazërit dhe se një kërkesë të tillë e plotëson vetëm prodhuesi Samsung duke qenë që është prodhues edhe i monitorit.

Më tej eksperti teknik ka hulumtuar dhe gjetur se prodhuesit kryesor të këtyre pajisje janë GE Healthcare, PhilipsHealthcare, SamsungMedison, SiemensHealthcare, Toshiba. Më tej është evidente se jo të gjithë prodhuesit e sipërpermendur prodhojnë të gjitha komponentat e pajisjes, sikurse është monitori. Në këtë rast prodhuesi GeneralElectric shfrytëzon monitor të prodhuar nga prodhuesit tjerë, kryesisht nga prodhuesi Sony të dedikuar për pajisje mjekësore. Mirëpo kjo nuk ka ndonjë mangësi apo pengesë në funksionin normal të pajisjes.

Andaj nisur nga parimi që specifikimet teknike duhet të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës, në rastin konkret kërkesa është kundër parimit të sipërpermendur, do thotë është në kundërshtim me nenin 28.2 të LPP-së.

Bazuar në sqarimet e mësipërme pretendimi ankimor është i qëndrueshëm dhe rekomandohet që të largohet kërkesa e tillë që monitori duhet të jetë i njëjtitbrend sikurse ultrazëri sepse ky specifikim e diskriminon OE ankues dhe OE tjerë potencial dhe nuk ka asnjë ndikim final apo efekt pozitiv në qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit përkatësisht rezultateve që priten nga kjo pajisje mjekësore.

Pretendimi ankimor 2 - ka tëbëjë me përfshirjen e të gjitha pajisjeve në një LOT edhe pse ato janë nga fusha komplet te ndryshme te përdorimit si: pajisje diagnostike, laboratorike, stomatologjike, kirurgjike, gjinekologjike, etj.

Sqarim – Ekspertët shqyrtues vlerësojnë se ky pretendim ankimorëështë i bazuar dhe se ndarja në lote do të siguronte një pjesëmarrje më të gjerëdhe konkurrencë më të barbartë ndërmjet Operatorëve Ekonomik, konform nenit 7 paragrafi 6 pika (i) dhe pika (iii) lidhur me nenin 27/A paragrafi 1 i LPP-së.

Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Eksperti shqyrtues / teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar dhe ky aktivitet i prokurimit të anulohet, dhe nëse AK edhe më tutje ka interes për zhvillim të këtij aktiviteti të prokurimit, lëndën ta kthej nëRitender duke bërë përmirësimet e dosjes së tenderit sipas rekomandimeve të dhëna mësipërm.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 22.05.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues sepajtohetme raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 24.04.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues senuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 29.05.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues ndërsa përfaqësuesit e OE-së ankuese nuk janë prezent ne seance edhe pse janë njoftuar ne mënyrë te rregullt për seance te njëjtit nuk na kanë njoftuar për arsyeje e mospjesëmarrjes ne këtë seance kushqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. . Reçica i cili deklaroj: Nuk jemi pajtuar me mendimin e eksperteve shqyrtues teknik sepse askund nuk kemi përmendur Firmën Samsung qe është përmendur nga OE ne ankese, ne konsultim edhe me njehin kërkuese ata pas marrjes se mendimit te ekspertit kanë konstatuar se kjo pajisje ju nevojitet për pune. Ne pretendimin 2 tek monitori 20 inch nuk është vetëm prodhuesi Samsung por ka edhe prodhues te tjerë për ketë produkt. Njësia kërkues ka thënë se çdo OE qe furnizon me pajisje mjekësore mundet me furnizua me ato pajisje.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Teknik z. Spahiu deklaroj: Pretendimi nuk ka te bej me përmendjen e Brendit dhe dimensionet e monitorit, pretendimi ka te bej me elementin ku kërkohet qe Prodhuesi brendi me kanë i njëjtë sikur se pajisja ne kemi hulumtuar prodhuesit e pajisjeve te tilla dhe jo te gjithë prodhuesit e pajisjeve prodhojnë monitorin i cili është edhe i integruar, shumica e prodhuesve te pajisjes shfrytëzojë monitor te prodhuar nga prodhues tjerë sikur se te prodhuesi General Elektrik HealthCare qe shfrytëzon monitor te prodhuar nga prodhuesi SONY. Andaj nisur nga parimi qe specifikimet teknike duhet te ofrojnë qasje te barabartë dhe nuk duhet te krijojnë mungesa te paarsyeshme ne konkurrence rekomandojmë qe te hiqet ky element i specifikacioni teknik për shkak qe nuk ndikim final apo ndikim ne procesin e këtij autoriteti te prokurimit rrjedhimisht nga rezultatet qe priten nga kjo pajisje.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: Propozojmë qe te refuzohet ankesa e OE ankuese dhe te vazhdohet me procedurën e mëtejshme nga Autoriteti Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues - teknik, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor,

duke u bazuar në sqarimet e ekspertit teknik sqaron se AKka kërkuar informata shtesë nga OE ankues me datë 17.05.2019 përmes e-mailit dhe në të njëjtën ditë ka pranuar nga OE sqarimin se pretendimi ka të bëjë specifikisht me elementin ku kërkohet që monitori të jetë brend i njëjte si prodhuesi i ultrazërit dhe se një kërkesë të tillë e plotëson vetëm prodhuesi Samsung duke qenë që është prodhues edhe i monitorit.

Paneli shqyrtues sqaron se eksperti teknik ka hulumtuar dhe gjetur se prodhuesit kryesor të këtyre pajisje janë GE Healthcare, PhilipsHealthcare, SamsungMedison, SiemensHealthcare, Toshiba. Më tej është evidente se jo të gjithë prodhuesit e sipërpërmendur prodhojnë të gjitha komponentat e pajisjes, sikurse është monitori. Në këtë rast prodhuesi GeneralElectric shfrytëzon monitor të prodhuar nga prodhuesit tjerë, kryesisht nga prodhuesi Sony të dedikuar për pajisje mjekësore. Mirëpo kjo nuk ka ndonjë mangësi apo pengesë në funksionin normal të pajisjes.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e ekspertit teknik konstaton se duke u nisur nga parimi që specifikimet teknike duhet të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës, konstatojmë se në rastin konkret kërkesa është kundër parimit të sipër përmendur, do thotë është në kundërshtim me nenin 28.2 të LPP-së. Andaj duke u bazuar në sqarimet e mësipërme pretendimi ankimor është i qëndrueshëm dhe se kërkesa e tillë që monitori duhet të jetë i njëjtit brend sikurse ultrazëri duhet që të largohet sepse ky specifikim e diskriminon OE ankues dhe OE tjerë potencial dhe nuk ka asnjë ndikim final apo efekt pozitiv në qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit përkatësisht rezultateve që priten nga kjo pajisje mjekësore. Paneli shqyrtues konstaton se kërkesa e lartcekur është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së për faktin se diskriminon një numër të OE-ve ndërsa favorizon OE-te të caktuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit që ka të bëjë me përfshirjen e të gjitha pajisjeve në një LOT edhe pse ato janë nga fusha komplet të ndryshme të përdorimit si: pajisje diagnostike, laboratorike, stomatologjike, kirurgjike, gjinekologjike, etj. Paneli shqyrtues duke u bazuar edhe në sqarimet e ekspertit teknik konstaton se ky pretendim ankimor është i bazuar dhe se ndarja në lote do të siguronte një pjesëmarrje më të gjerë dhe konkurrencë më të barbare ndërmjet Operatorëve Ekonomik, konform nenit 7 paragrafi 6 pika (i) dhe pika (iii) lidhur me nenin 27/A paragrafi 1 i LPP-së.

Paneli shqyrtues duke pasqyruar sqarimet e dhëna si më lart konstaton se autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit ka vendosur kërkesa në kundërshtim me nenin 7 dhe 28 të LPP-së andaj AK është i

obliguar që ti përmirësoj kërkesa e vendosura në kundërshtim me dispozitat e cekura si më lart , duke vepruar në pajtim me nenin 57.3 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi Paçarizi



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –KK- Lipjan,

1x1 OE- “N.T.P YessPharma” Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.